

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "A1 Consulting" Sh.p.k.

Sot, më datë 02/11/2023,

- **Znj. Silvia Zerbo**, shtetase italiane, lindur me 29/10/1973, në Itali, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me nr. Personal YB6648148, madhor e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Z. Elidjon Gjergji**, shtetas shqiptar, lindur me 14/09/1987, në Libofshe, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. personal I70914016G, madhor e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**A1 Consulting**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**A1 Consulting**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake nr.7, Rruga "Muhamet Gjollësia", Godina Qendra Tregtare Ring, Shkalla 2, Kati 6, Apartamenti 6, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Shoqëria ofron keshillim dhe shërbime konsulente për teknologjinë e informacionit dhe teknologjinë kompjuterike, financiare dhe administrim biznesi;
- Krijon, zhvillon, zbaton dhe miremban programe kompjuterike, teknologji informacioni të prodhuar nga Shoqëria ose pale të treta dhe integrimin e sistemeve teknologjike dhe çdo veprimtari tjetër që gjeneron të ardhura dhe që nuk bie ndesh me ligjet Shqiptare në fuqi;
- Tregtim i pajisjeve të teknologjise se informacionit, tregtim të pajisjeve të zyrës, tregtise se pajisjeve dhe njesive elektronike dhe telekomunikacionit;
- Dhenie me qira të pajisjeve të teknologjise se informacionit dhe aktivitete të tjera të shërbimit të teknologjise se informacionit dhe kompjuterit, etj;
- Shërbime IT dhe Zhvillim Software;
- Ofrim i zgjidhjeve në fushën e teknologjise se informacionit, ndërtim dhe implementim të sistemeve IT për menaxhimin e kompanive të vogla, të mesme, të mëdha si dhe organizatave dhe institucioneve publike dhe jopublike, vendase ose të huaja;

- Tregtim import/eksport te sistemeve elektronike dhe paisjeve ne fushen e teknologjise se informacionit. Per me teper shoqeria mund te veproje si agjent/ndermjetes per kryerjen e aktiviteteve te mesiperme dhe bazuar ne diskrecionin e saj te vetem mund te kontraktoje pale te treta per kryerjen e nje pjese apo te te gjitha sherbimeve te mesiperme.
- Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj perfshire edhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave. Per te arritur objektin e saj, Shoqeria mund te realizoje drejtperdrejte apo ne menyre te terthorte çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqiptare apo te huaja, si edhe te hyje ne marredhenie kontraktore, bashkepunimi ose ortakerie me persona te trete, private ose publike, vendas ose te huaj te kryeje çdo aktivitet tjetër te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj perfshire edhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave;
- Zhvillim, implementim dhe mirembajtje te sistemeve dhe programeve ne fushen e teknologjise se informacionit;
- Prodhimi, shitja dhe asistenca e software dhe rrjeteve informatike, menaxhimi i qendrave te perpunimit te te dhenave dhe te rrjeteve informatike te cdo lloji. Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve te internetit, ofrim domain-esh, sherbime web hosting, sherbimeve te telekomunikacionit, pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale ne internet si dhe marketing online. Zhvillim, software, platforma dixhitale, e-commerce dhe shitja e programeve kompjuterike per perdorim ne fusha te ndryshme. Ofrimi i sherbimeve te ndryshme informatike ne fushen e teknologjise se informacionit.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 100.000 Lek (*njëqind mijë lek*) dhe është i përbërë nga dy kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Silvia Zerbo**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lek (*pesëdhjetë mijë lek*) dhe 50.000 Lek (*pesëdhjetë mijë lek*) të kapitalit themeltar.
- **Z. Elidjon Gjergji**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lek (*pesëdhjetë mijë lek*) dhe 50.000 Lek (*pesëdhjetë mijë lek*) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën e parashikuara për ndryshimin e këtij Akt themelimi.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
Z. Elidjon Gjergji shtetas shqiptar, me 14/09/1987, në Libofshe, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. personal I70914016G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8


DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Elidjon Gjergji* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

SILVIA ZERBO



ELIDJON GJERGJI

